



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL A.nr.9/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi, kryesues, Kujtim Pasuli, dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Egzonë Maloku, me vendbanim në Nerodime e poshtme, Komuna Ferizaj, të parashtruar ndaj vendimit të KQZ-së, me nr. Protokolli 01/2318/2025 datë 03.09.2025, për refuzimin e kundërshtimit administrativ në lidhje me aplikimin për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.09.2025, mori këtë :

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.9/2025 datë 04.09.2025, e parashtruar nga Egzonë Maloku, me vendbanim në Nerodime e poshtme, Komuna Ferizaj parashtruar kundër Vendimit me nr. Protokolli 01/2318/2025 datë 03.09.2025, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos regjistrimit si votues jashtë Kosove për Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 04.09.2025, PZAP-i, përmes email-it zyrtar ka pranuar një ankesë nga Egzonë Maloku, me vendbanim Nerodime e poshtme, Komuna Ferizaj, në të cilën pretendohet se e njëjta ka aplikuar për regjistrim si votues jashtë Kosovës për zgjedhjet komunale. Parashtruesja e ankesës thekson se KQZ e ka refuzuar aplikimin e saj me arsyetimin e mungesës së adresës së plotë. E njëjta thekson se menjëherë pas marrjes së njoftimit nga KQZ ka parashtruar ankesë dhe ka ofruar dëshmi shtesë të vlefshme të cila e vërtetojnë adresën e saj të banimit jashtë Kosovës. Parashtruesja e ankesës thekson se pavarësisht dorëzimit të këtyre dëshmive të plota dhe të ligjshme, KQZ nuk e ka pranuar aplikimin e saj duke i pamundësuar të drejtën e votës. E njëjta thekson se këto veprime janë në kundërshtim me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6 të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, duke kërkuar nga PZAP-i që të konstatojë se refuzimi i KQZ-së është i pabazuar dhe ta obligoj KQZ-në qeta përfshijë në listën e votuesve jashtë Kosovës dhe ti mundësohet e drejta për të votuar.

Parashtruesi në ankese ka bashkangjitur dëshmitë si kopje e letërnjoftimit, dhe dokumentin e sigurimit shëndetësor.

Në përgjigje në kërkesë të KQZ-së, KQZ, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën e juaj, jep sqarimet/përgjigjet si më poshtë:

Shtetasja Egzonë Maloku, me numër personal të Republikës së Kosovës 1242661121, ka aplikuar përmes platformës elektronike. Shërbimi për votues ka shqyrtuar aplikimin dhe

aplikuesi është njoftuar përmes emailit, në email adresën e dhënë gjatë aplikimit (xona0301@gmail.com) për refuzimin e aplikimit të tij me arsyen e refuzimit: “Mungon dokumenti që dëshmon adresën e banimit”, meqë dëshmia e bashkangjitura nuk plotësonte kërkesat e përcaktuara në rregulloren sikurse përcaktohet në nënparagrafin 4.4, të nenit 3, të Rregullores Zgjedhore Nr.04/2025, Regjistrimi dhe Votimit Jashtë Kosovës, ku thuhet: “aplikuesi fotografon dokumentin që dëshmon adresën e votuesit jashtë Kosovës, sikurse në nën paragrafin 4.1.” . Refuzimi është bërë për faktin se në dëshminë e bashkangjitur është paraqitur, dëshmia e ngarkuar nga shtetasja përmban vetëm të dhënat themelore, por nuk përmban informata për llojin e dëshmisë. Sipas Procedurës Standarde të Veprimit për Regjistrimin e Votuesve Jashtë Kosovës, pika 2.3.2 përcakton qartë llojin e dokumentit që duhet të bashkëngjitet për të dëshmuar adresën e banimit apo vendqëndrimin jashtë Kosovës, si vijon: Dokument identifikues ku figuron adresa e banimit; Vërtetim i adresës nga autoriteti lokal; Kontrata e qirasë apo dëshmi tjetër e banimit; Fatura e shërbimeve; Dokument i lëshuar nga banka ose kompania e sigurimit.

Të njëjtat kategori të dokumenteve janë të paraqitura edhe në imazhet dhe videot sqaruese në platformën e regjistrimit online për votuesit jashtë Kosovës.

KQZ ka pranuar kundërshtimin administrativ të shtetasit znj. Egzonë Maloku, parashtruar përmes emailit në email adresën kundërshtimi.vjk@kqz-ks.org, me datë 30.08.2025, ora: 18:39. Në kundërshtim, e njëjta ka paraqitur pretendimet si vijon: “Te bashkangjitur gjeni dokumentin që e dëshmon vendbanimin që ma keni refuzuar kërkesën për votim jashtë vendit” Së bashku me kundërshtimin, parashtruesja ka bashkangjitur dëshminë e adresës si vijon:

KQZ ka themeluar Komisionin për Kundërshtim Administrativ (Komisioni), i cili ka shqyrtuar të gjitha kundërshtimet e pranura, përfshirë edhe kundërshtimin e paraqitur nga votuesja.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe pretendimeve të votueses, Komisioni ka konstatuar se kundërshtimi administrativ rekomandohet të refuzohet, pasi nuk përmban elementet e kërkuara në Procedurën Standarde të Veprimit për Regjistrimin e Votuesve Jashtë Kosovës si dhe në udhëzimet e dhëna përmes email-it zyrtar.

Në veçanti, është e detyrueshme që bashkëngjitja e fotografisë së aplikuesit me dokument identifikues të Kosovës në dorë të jetë pjesë e kundërshtimit, kusht ky që në rastin konkret nuk është përmbushur.

Komisioni e ka paraqitur rekomandimin në mbledhjen e KQZ-së nr. 54/2025, të mbajtur më 03.09.2025, ku ndër të tjera është rekomanduar refuzimi i kundërshtimit të parashtrueses. Pas shqyrtimit, KQZ ka miratuar rekomandimin e Komisionit me vendimin nr. 01/2318/2025, duke refuzuar kundërshtimin administrativ të ankueses. E njëjta është njoftuar me email më 03.09.2025 lidhur me vendimin e KQZ-së, si dhe me të drejtën e ushtrimit të ankesës në PZAP brenda afateve ligjore.

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ankuesi, gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli e vlerësoj lejueshmërinë e ankesës dhe ka ardhur në përfundim se e njëjta i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 98 paragrafi 3 të Ligjit NR.08/L-228 për Zgjedhjet e

Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe në nenin 4 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave,

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën, dhe vendimin nr. 01/2318/2024 datë 03.09.2025, të KQZ-së, konstatoi se i njëjti është i drejtë, dhe i ligjshëm, bazuar në këtë vlerësoi se ankesa është e pabazuar, pasi që parashtruesi i ankesës gjatë aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës nuk i ka plotësuar kriteret përcaktuara në rregulloren sikurse përcaktohet në nën paragrafin 4.4, të nenit 3, të Rregullores Zgjedhore Nr.04/2025, Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, ku thuhet: “aplikuesi fotografon dokumentin që dëshmon adresën e votuesit jashtë Kosovës, sikurse në nën paragrafin 4.1.” Po ashtu sipas Procedurës Standarde të Veprimit për Regjistrimin e Votuesve Jashtë Kosovës, pika 2.3.2 përcakton qartë llojin e dokumentit që duhet të bashkëngjitet për të dëshmuar adresën e banimit apo vendqëndrimin jashtë Kosovës, si vijon: Dokument identifikues ku figuron adresa e banimit; Vërtetim i adresës nga autoriteti lokal; Kontrata e qirasë apo dëshmi tjetër e banimit; Fatura e shërbimeve; Dokument i lëshuar nga banka ose kompania e sigurimit.

Nga shkresat e lëndës, si dhe nga përgjigja e KQZ-së, Paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës në momentin e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës, përmes platformes elektronike të KQZ-së, pavarësisht faktit që aplikuesi kishte bashkëngjitur disa dokumente të kërkuara si kopje të letërnjoftimit, dhe kopje të sigurimit shëndetësor aplikacioni i saj nuk përmban elementet e kërkuara në Procedurën Standarde të Veprimit për Regjistrimin e Votuesve Jashtë Kosovës si dhe në udhëzimet e dhëna përmes email-it zyrtar.

Pra duhet theksuar se është e detyrueshme që bashkëngjitja e fotografisë së aplikuesit me dokument identifikues të Kosovës në dorë të jetë pjesë e kundërshtimit, kusht ky që në rastin konkret nuk është përmbushur.

Në aplikimin e tij, parashtruesi i ankesës kishte bashkëngjitur kopje të letërnjoftimit.

Megjithatë, përveç këtyre dokumenteve, sipas procedurave të KQZ-së, kërkohet një verifikim i dyfishtë i identitetit të votuesit. Ky kriter specifikon që aplikuesi duhet të ngarkojë një fotografi të tij, në të cilën ai duhet të mbajë dokumentin e tij të identitetit siç është letërnjoftimi në dorë, duke mundësuar që verifikimi të bëhet vizualisht dhe në mënyrë të kjartë.

Në rastin konkret, aplikuesi ka ngarkuar një foto të letërnjoftimit, por nuk ka plotësuar kërkesën e KQZ-së, për fotografi të vetvetes duke mbajtur dokumentin e identitetit. Ajo ka dërguar një shkresë me adresë të vendbanimit, por kjo shkresë nuk ka përmbushur kërkesën si dokument identifikues ku figuron adresa e banimit, pasi që prova e bashkëngjitur në ankesë nuk përmbante elementin e domosdoshëm : Dokument identifikues ku figuron adresa e banimit, vërtetim i adresës nga autoriteti lokal, kontrata e qirasë apo dëshmi tjetër e banimit, fatura e shërbimeve, dokument i lëshuar nga banka ose kompania e sigurimit, dhe kjo ka rezultuar në mos plotësimin e kriteve të rregulluara me nenin 5.1, dhe 5.4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 4/2025, për Regjistrimin dhe Votimin jashtë Kosovës të KQZ-së, ku në këtë nenin 5.4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 4/2025, për Regjistrimin dhe Votimin jashtë Kosovës të KQZ-së ndër të tjera thuhet se “ *Kërkesa për regjistrim përmes postës bëhet duke plotësuar bashkëngjitur : 5.4 dërgon fotografinë e tij, ku shihet qartë fytyra e tij/saj duke mbajtur në dorë dokumentin identifikues të Republikës së Kosovës*”.


Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3, 118 paragrafi 1, neni 119 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.A nr. 9/2025 më datën 06.09.2025

Kryesues i Panelit,

Bujar Muzaqi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.